

VENDIM
Nr. 564, datë 16.7.2020

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 555, DATË 11.8.2011, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR MIRATIMIN E STRUKTURËS DHE TË NIVELEVE TË PAGAVE TË PUNONJËSVE ME ARSIM TË LARTË DHE TË PUNONJËSVE TË INFERMIERISTIKËS, NË SISTEMIN E MINISTRISË SË SHËNDETËSISË DHE NJËSINË MJEKËSORE USHTARAKE, PRANË SPITALIT UNIVERSITAR TË TRAUMËS, SI DHE PËR TRAJTIMIN E PERSONELIT MJEKËSOR NË STRUKTURAT E FORCAVE TË ARMATOSURA”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 2, të nenit 4, të ligjit nr. 10405, datë 24.3.2011, “Për kompetencat për caktimin e pagave dhe të shpërblimeve” dhe të ligjit nr. 88/2019, “Për buxhetin e vitit 2020”, të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Lidhja nr. 4, që përmendet në pikën 13, të vendimit nr. 555, datë 11.8.2011, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, zëvendësohet me lidhjen me të njëjtin numër dhe me emërtimin “Struktura dhe nivelet e pagave, për mjekët me tituj e grada shkencore”, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Efektet financiare që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, për vitin 2020, të përballohen nga buxheti i miratuar për Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, për këtë vit.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i fillon efektet nga data 1 mars 2020.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

Lidhja nr. 4

Struktura dhe nivelet e pagave për mjekët me tituj dhe grada shkencore

Kualifikimi/Grada/Titulli Shkencor	Paga bazë mujore (lekë/muaj)	Shtesa për kushte pune (lekë në muaj)
1	2	3
Shef shërbimi nga kategoria “Profesor”	123.800	8600
Shef shërbimi nga kategoria “Docent”	106.700	7400
Profesor	121.000	8500
Profesor i asociuar	105.200	7300
Docent	95.800	6700